

النصائح المفيدة في تحريم الغيبة والنميمة

KËSHILLA TË DOBISHME NË LIDHJE ME NDALESËN E  
PËRGOJIMIT DHE THASHETHEMEVE

Muhamed bin Sulejman el-'Ulejit



**KËSHILLA TË DOBISHME NË LIDHJE ME  
NDALESËN E PËRGOJIMIT DHE  
THASHETHEMEVE  
& PËRMBLEDHJE SHITESË NGA PËRKTHYESI**

**النصائح المفيدة في تحريم الغيبة والنميمة**

**محمد بن سليمان العليط**

**TITULLI ORIGINAL:**

En-Neşā'ihul-Mufideh fī Taḥrīm el-Gībeh ve en-  
Nemīmeḥ

**AUTORI:**

Muhamed bin Sulejman el-'Ulejti

**PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:**

Abdullah Avdyli

## **REDAKTOR GJUHËSOR:**

Nazmi Shaqiri  
Zymer Mehani

## **REALIZIMI KOMPJUTERIK:**

Enter-Design

**KOSOVË, 1445 / 2024**

© Të gjitha drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk lejohet të riprodhohet nëpërmjet çdo mënyre ose mjeti, qoftë elektronik apo mekanik, përfshirë fotokopjimin ose çdo lloj mjeti që përdoret për ruajtjen e informacionit, pa lejen paraprake të përkthyesit. Gjithashtu nuk lejohet të shitet apo të shfrytëzohet për ndonjë interes personal.

Gmail: [abdullahavdylialb@gmail.com](mailto:abdullahavdylialb@gmail.com)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

## PARATHËNIA

Falënderimi i takon Allahut, Atë e falënderojmë, ndihmë dhe falje prej Tij kërkojmë. Gjithashtu prej Tij kërkojmë mbrojtje të na ruajë nga e keqja e vetes sonë, si dhe nga punët tona të këqija. Atë që Allahu e udhëzon në rrugën e drejtë, askush nuk ka mundësi ta devijojë, dhe atë që Allahu e devijon nga rruga e drejtë, askush nuk ka mundësi ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe pa ortak, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Pastaj:

Ky është një fragment i shkurtër i cili paralajmëron kundër përgojimit dhe thashethemeve, si dhe sqaron ndalesën e tyre, duke përmendur argumente nga Kurani Fisnik, Hadithet Profetike dhe Konsensusi i Dijetarëve.<sup>1</sup>

---

### Përmbledhje shtesë nga përkthyesi:

<sup>1</sup>Ibn Hazmi, ka thënë:

**“Të gjithë dijetarët kanë rënë në ujdin për ndalesën e përgojimit dhe thashethemeve, përveç në ato raste kur këshilla është e domosdoshme.”**

Shiko, Meratib el-Ixhma', (nr. 1568).

Ajo çfarë përcillet në gjithë këtë fragment është thjesht një porosi e sinqertë drejtuar të gjithë muslimanëve, duke u bazuar në hadithin e Profetit, (ﷺ): **“Feja është të kesh sinqeritet.”**<sup>2</sup>

E lus Allahun që këtë punim ta llogaritë vepër të sinqertë dhe të kryer vetëm për Fytyrën e Tij Fisnike, si dhe e lus që Ai t'ua mundësojë vëllezërve tanë muslimanë të përfitojnë prej tij. Mëshira dhe paqja e Allahut qofshin për Profetin tonë Muhamedin, për familjen dhe të gjithë shokët e tij!

---

• Imam Neveviu, ka thënë: **“Për dispozitën e përgojimit dhe thashethemeve, ato janë të ndaluara me pajtimin e gjithë muslimanëve. Për ndalesën e tyre tregojnë argumentet e qarta nga Kurani, Suneti dhe Konsensusi i këtij Umeti.”** Shiko, Kitab el-Edhkar, kapitulli, “Ruajtja e gjuhës”, tema, “Ndalesa e përgojimit dhe e thashethemeve”, (fq. 542), Imam Nevevi.

• Imam Mundhiri në librin e tij, Et-Tergib ve et-Terhib, ka thënë: **“I gjithë ky Umet ka rënë në ujdë për ndalesën e thashethemeve, dhe se është njëra nga mëkatet e mëdha tek Allahu i Lartësuar.”**

<sup>2</sup> Shiko, Sahih Muslim, (nr. 55).

## NDALESA E PËRGOJIMIT SIPAS KURANIT

Allahu thotë:

**“...dhe mos përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është Mëshirues i madh, Ai e pranon shumë pendimin.”<sup>3</sup>**

(El-Huxhurat: 12)

---

<sup>3</sup> Es-Sahib bin 'Abbad, në formë të poezisë ka thënë:

**“Kujdes nga përgojimi, sepse është mëkat për të cilin ndalesë ka,**

**Vërtetë përgojuesi është njësoj sikur ai që mishin e vëllait të tij ha.”**

Shiko, Divan es-Sahib bin 'Abbad, (fq. 106); Behxheh el-Mexhalis, “Kapitulli i përgojimit dhe thashethemeve”, (1/398), Ibn 'Abdul- Berr.

- Njëherë 'Amr bin el-'Asi, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), kaloi afër një mushku të ngordhur, dhe u tha atyre që ishin aty prezent: **“Betohem në Allahun, vërtetë sikur dikush prej jush ta hante mishin e kësaj ngordhësire, do të ishte më mirë sesa ta hante mishin e vëllait të tij musliman (ta përgojonte).”** Shiko, Kitab el-Gibeh ve en-Nemimeh, (nr. 38), Ibn Ebi Dunja; Kitab ez-Zuhd, “Kapitulli i përgojimit”, (nr. 433), Imam Veki'; Kitab ez-Zuhd, “Kapitulli i përgojimit”, (nr. 1174), Imam Hanad. Sahih mevkuf, shiko, Sahih et-Tergib ve et-Terhib, (nr. 2838).

Ibn Kethiri, në librin e tij të tefsirit<sup>4</sup>, ka thënë: “Ky ajet përbën ndalesë që të bëhet përgojim. I Dërguari i Allahut, (ﷺ), e ka sqaruar çështjen e përgojimit në një hadith të cilin e transmeton Ebu Davudi me zinxhir deri tek Ebu Hurejrah, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se ka thënë: “I Dërguari i Allahut, (ﷺ), kur është pyetur për çështjen e përgojimit, u përgjigj duke thënë: **“Përgojimi është ta përmendësh vëllain tënd (para njerëzve) për diçka që ai nuk ka fare dëshirë.”** Pastaj përsëri u pyet: “Çfarë mendon nëse ajo për të cilën unë e përmend vëllain tim (para njerëzve) është e vërtetë?” Ai, (ﷺ), u përgjigj duke thënë: **“Nëse është e vërtetë ajo për të cilën ti e përmend atë, megjithatë ky është përgojim ndaj tij, ndërsa nëse nuk është e vërtetë ajo për të cilën ti e përmend atë, në këtë rast kjo është shpifje ndaj tij.”**<sup>5</sup>

---

<sup>4</sup>Shiko, Tefsir el-Kuran el-'Adhim, (6/716), Imam Ibn Kethir.

<sup>5</sup> Shiko, Sunen Ebu Davud, “Kapitulli i edukatës”, “Tema e përgojimit”, (nr. 4874). Hadith autentik, shiko, “Sahih Sunen Ebu Davud”, “Kapitulli i edukatës”, “Tema e përgojimit”, (nr. 4874).



---

• Ibn Ethiri, ka thënë: **“Përgojimi do të thotë të përmendet për të keq ndonjë person, kur ai nuk është aty prezent (mungon në atë ndejë), edhe nëse realisht ai është pikërisht ashtu siç përmendet (për tiparet e tij të këqija, të dobëta, të mangëta etj), ndërsa nëse ai përmendet për diçka që realisht nuk është ashtu, në këtë rast kjo është shpifje dhe gënjeshtër ndaj tij.”**

Shiko, En-Nihajeh fi Garib el-Hadith ve el-Ether, “Kapitulli i shkronjës Gajnun bashkë me Jaun”, (nr. 11728), Imam Ibn Ethir.

• Njëherë Muhamed bin Sirini ishte duke e përmendur një person, me çrast për të tha: **“Ai i ziu”** Pastaj tha: **“Kërkoj falje nga Allahu, frikësohem se e përgojova (folë keq për të).”**  
Shiko, Kitab ez-Zuhd, “Kapitulli i përgojimit”, (nr. 434), Imam Veki; Kitab ez-Zuhd, “Kapitulli i rrëfimeve”, (nr. 1191), Imam Hanad.

• Muhamed bin Sirini, ka thënë: **“Nëse ti i përmend (para njerëzve) gjërat e këqija të vëllait tënd, ndërsa fare nuk i përmend gjërat e tij të mira, atëherë pra ti je i padrejtë ndaj tij.”**

Shiko, El-Xhami’ li-Ahlak er-Ravi ve Adab es-Sami’, (nr. 1635), Hatib el-Bagdadi.

• Hamdun bin Ahmed, ka thënë:

**“Mos ia zbuloj dikujt ndonjë mangësi, për të cilën mangësi ti për vetën tënde do të dëshiroje të mbetesh e mbuluar!”**

Shiko, Sifeh es-Safveh, (4/122), Ibn Xhevi.

• Ebu Hatim, ka thënë:

**“Tregtia më fitimprurëse është përmendja e Allahut, ndërsa tregtia më e dështuar është përmendja e njerëzve (për të keq).”**

• Fudejl bin ‘Ijad, ka thënë:

**“Përmendja e njerëzve (për të keq) është sëmundje, ndërsa përmendja e Allahut është ilaç.”**

Shiko, Behxheh el-Mexhalis, “Kapitulli i përgojimit dhe thashethemeve”, (1/399), Ibn ‘Abdul-Berr.

## NDALESA E PËRGOJIMIT SIPAS HADITHEVE PROFETIKE

Në realitet numri i përgojimeve është më i madh sesa ti mendon. Gjithashtu, në mesin e njerëzve ato janë të përhapura më shumë sesa ti kujton<sup>6</sup>. Në dashtë Allahu, do t'i tregojmë disa pika kryesore të thjeshtësuara për çështjen e përgojimit, prej tyre:

Buhariu, në Sahihun e tij, thotë: “Tema e përgojimit”:  
Fjala e Allahut të Lartësuar:

**“...dhe mos përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është Mëshirues i madh, Ai e pranon shumë pendimin.”**

---

<sup>6</sup> Në anën sipërfaqësore, ne të gjithë e dimë se numri i tyre është i madh, dhe se ato janë mjaft të përhapura në mesin e njerëzve. Nëse futemi më thellë, ato janë edhe më shumë se kaq, kjo, sepse në anën tjetër të fshehur, ka edhe përgojime tjera të cilat bëhen, por ne nuk jemi në dijeni për këto përgojime të fshehura prej nesh. Tani e kuptove përse numri i tyre është edhe më i madh sesa mendojmë?

- Ibn Xhevzi, ka thënë: **“E kam vërejtur se disa zakone (të gabuara) kanë dominuar në mesin e njerëzve, të cilat ndikojnë në humbjen e kohës së tyre. Kur ata e vizitojnë njëri-tjetrin, nuk shpëtojnë nga rënia në muhabete të padobishme dhe përgojime, e që më e pakëta brenda gjithë kësaj është humbje e kohës.”**

Shiko, El-Adab esh-Sheri’jeh ve el-Minah el-Meri’jeh, (3/345), Ibn Muflih.

Pastaj, në vijim e përmend hadithin e transmetuar nga Ibn 'Abbasi, (Allahu qoftë i kënaqur me këta të dy!), se ka thënë: “Njëherë i Dërguari i Allahut, (ﷺ), kaloi pranë dy varreve, dhe tha: **“Këta dy të vdekur janë duke u ndëshkuar (në varret e tyre), dhe nuk janë duke u ndëshkuar për diçka të madhe (pra, jo diçka e madhe tek njerëzit, porse tek Allahu është e madhe). Njëri, gjatë procesit të tij të urinimit, nuk ruhej nga spërkatjet me urinë, ndërsa tjetri bartte fjalë ndërmjet njerëzve”**. Pastaj e kërkoi një degë të njomë dhe e theu në dy pjesë, njërën pjesë e mbolli te njëri varr, ndërsa pjesën tjetër e mbolli te varri tjetër, dhe pastaj tha: **“Me shpresë që dënimi i tyre të lehtësohet, përderisa këto dy degët e njoma nuk thahen.”**<sup>7</sup>

---

• Fudejl bin 'Ijad, ka thënë: **“Kur fillon të përhapet përgojimi, fillon të shembet vëllazëria e ndërtuar për hir të Allahut.”** Shiko, Hiljeh el-Evljia', (8/96), Ebu Nu'ajm el-Asbahani.

<sup>7</sup> Shiko, Sahih el-Buhari, “Kapitulli i edukatës”, “Tema e përgojimit”, (nr. 6052).

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se Profeti, (ﷺ), gjatë fjalimit të tij në Haxhin lamtumirës, ka thënë: **“Vërtetë gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të shenjta (të paprekshme) ndërmjet jush, njashthu sikurse shenjtëria e kësaj dite, e këtij muaji dhe e këtij vendi. A e kam kumtuar mesazhin?”**

Transmetohet në Sunenin e Ebu Davudit, se ‘Aishja, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: “I thashë Profetit, (ﷺ): “Ty të mjafton Safija e cila është kaq” (duke synuar të thotë se ajo është me fizionomi të shkurtër), dhe pastaj Ai, (ﷺ), më tha: **“Vërtetë ke thënë një fjalë e cila sikur të përzihet me ujin e detit, do ta bënte të turbullt.”**<sup>8</sup>

Transmetohet nga Muadhi, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se i Dërguari i Allahut, (ﷺ), i ka thënë atij: **“Mos të pastë nëna, o Muadh!” A i hedh njerëzit me fytyrë apo me hundë në Xhehenem diçka tjetër përveç ajo çfarë del nga gjuhët e tyre (shprehjet e këqija dhe të shëmtuara)?”**<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> Shiko, Sunen Ebu Davud, “Kapitulli i edukatës”, “Tema e përgojimit”, (nr. 4875). Hadith autentik, shiko, Sahih el-Xhami’, (nr. 5140).

<sup>9</sup> Shiko, Sunen et-Tirmidhi, (nr. 2616). Tirmidhiu thotë se hadithi është hasen-sahih; Sunen Ibn Maxheh, (nr. 3973); Musned el-Bezzar, (nr. 2643); El-Mu’xhem el-Kebir, (20/127-128), Tabarani. Hadith autentik, shiko, Sahih Sunen et-Tirmidhi, (nr. 2616).

Transmetohet një hadith tjetër, ku Profeti, (ﷺ), ka thënë: **“Vërtetë tek Allahu kamata më e keqe është të llogaritet i lejuar cenimi i nderit të muslimanit”**, pastaj lexoi ajetin kuranor: **“E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtare, për çka ata nuk janë fajtorë...”** (El-Ahzab: 58).<sup>10</sup>

Ibn Ebi Dunja dhe Bejhakiu transmetojnë se Profeti, (ﷺ), ka thënë:

**“Përgojimi është më i keq sesa imoraliteti”**, pastaj u pyet: “Përse?” Ai, (ﷺ), u përgjigj duke thënë: **“Kjo, sepse laviri kryen imoralitet dhe pastaj pendohet tek Allahu, e Ai ia pranon pendimin, ndërsa përgojuesi e përgojon dikë, e Allahu nuk ia fal mëkatën e përgojimit, derisa edhe i përgojuari ta fal përgojuesin në fjalë.”**<sup>11</sup>

Imam Mundhiri, në lidhje me këtë transmetim, ka thënë: **“Më shumë tingëllon se është Mevkuf (fjalë e sahabiut).”**

---

<sup>10</sup> Shiko, Mexhma' ez-Zeva'id, (nr. 13159), Imam Hejthemi.

<sup>11</sup> Hadith i dobët (daif), shiko, Daif et-Tergib ve et-Terhib, (nr. 1690).

Transmeton Ebu Davudi me zinxhir deri tek Enes bin Malik, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se ka thënë: “I Dërguari i Allahut, (ﷺ), ka thënë: **“Kur jam ngritur lart në qiej, atje gjatë udhëtimit kalova pranë disa njerëzve të cilët kishin thonjë të bakrit me të cilët i gërvishnin fytyrat dhe gjokset e tyre, e pyeta Melekun Xhibril: “Kush janë këta o Xhibril?” Ai u përgjigj: “Këta janë ata të cilët e kanë ngrënë mishin e njerëzve (i kanë përgjuar), si dhe e kanë cenuar nderin e tyre.”**<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> Shiko, Sunen Ebu Davud, “Kapitulli i edukatës”, “Tema e përgojimit”, (nr. 4878). Hadith autentik, shiko, Sahih Sunen Ebu Davud, (nr. 4878).

- Transmetohet se Allahu i ka shpallur Musait, (alejhi selam): **“Kush vdes i penduar nga mëkati i përgojimit, i tilli do të jetë prej atyre të cilët të fundit do të hyjnë në Xhenet. Kush vdes i papenduar nga mëkati i përgojimit, i tilli do të jetë prej atyre të cilët të parët do të futen në Xhehenem.”** Shiko, Er-Risaleh el-Kushejrijeh, “Kapitulli i përgojimit”, (fq. 284).

**ATO ÇFARË JANË TRANSMETUAR NGA SAHABËT,  
(ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TA!), NË LIDHJE  
ME TEMËN E PËRGOJIMIT, JANË TË SHUMTA,  
NJË PREJ TYRE:**

Transmetohet se njëherë ‘Umeri, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), shkoi tek Ebu Bekri, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), dhe e gjeti duke e tërhequr gjuhën e tij nga jashtë, kështu që ‘Umeri reagoi duke i thënë: **“Ndalo, Allahu të faltë!”** Ebu Bekri u përgjigj: **“Vërtetë kjo gjuha ime më ka hedhur në humnera.”**<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> Shiko, Muvetta’ e Imam Malikut, (nr. 1833). Sahih mevkuuf, shiko, Sahih et-Tergib ve et-Terhib,(nr. 2873).

**ATO ÇFARË JANË TRANSMETUAR NGA  
TABI'INËT DHE GJENERATAT E RADHËS PAS  
TYRE NË LIDHJE ME TEMËN E PËRGOJIMIT,  
JANË TË SHUMTA, PREJ TYRE:**

Katadeh, ka thënë: “Na është bërë me dije se në varr ka ndëshkim edhe për këto tri shkaqe, të renditura në tre të tretën: “Një e treta, për shkak të përgojimit; një e treta tjetër, për shkak të moskujdesit gjatë urinimit, si dhe një e treta tjetër, për shkak të bartjes së fjalëve ndërmjet njerëzve.”<sup>14</sup>

Kurtubiu ka sjellë konsensus (ixhma') të dijetarëve se përgojimi konsiderohet prej mëkateve të mëdha.<sup>15</sup>

Poashtu, prej mëkateve të mëdha është edhe: imoraliteti, konsumimi i pijeve dehëse, vjedhja, shkëputja e lidhjeve farefisnore, mosbindja ndaj prindërve, si dhe të ngjashme. Allahu na ruajtë nga vazhdimësia në atë rrugë, e cila është e rrejshme!

---

<sup>14</sup> Shiko, Kitab es-Samt ve Adab el-Lisan,(nr. 188), Ibn Ebi Dunja.

<sup>15</sup> Kurtubiu, ka thënë:

**“Nuk ka mospajttime në mesin e dijetarëve se përgojimi është prej mëkateve të mëdha.”**

Shiko, El-Xhami' li-Ahkam el-Kuran,(19/405).



Imam Neveviu, ka thënë: **“Përgojimi është të përmendet një person për diçka që ai nuk ka dëshirë, pa marrë parasysh qoftë kjo në lidhje me gjymtyrët trupore të tij, çështjet e tij të fesë, veprimet e tij që zakonisht i bën, personalitetin e tij, fizionominë e tij, moralin e tij, pasurinë e tij, prindërit e tij, fëmijët e tij, bashkëshorten e tij, shërbëtorin e tij, rrobat e tij, gjestet e tij, karakterin e tij të lirshëm dhe të hapur (person i lirshëm dhe i hapur në të folur e në të qeshura etj), reagimet e tij në formë pakënaqësie apo diçka tjetër.”**<sup>16</sup>

Ibn Haxher el-Hejtemi, ka thënë:

**“Gjuha jote është sikurse shembulli i luanit tënd, të cilin e ke pranë vetës. Nëse e zgjidh nga zinxhiri, ai do të kthehet dhe do të të kafshojë, e nëse e mban të lidhur, përkundrazi, ai do të të mbrojë (nga kundërshtarët dhe kafshët grabitqare).”**<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> Shiko, Fet’hul-Bari bi Sherh Sahih el-Buhari,(18/417), Imam Ibn Haxher el-’Askalani.

<sup>17</sup> Shiko, El-Fet’hul-Mubin bi Sherh el-Erbe’in,(fq. 491), Ibn Haxher el-Hejtemi.

Transmetohet se njëherë disa persona kanë kaluar pranë një faltoreje, me çrast aty brenda ishte një adhurues. Këta persona e pyetën këtë adhuruesin: “Si quhesh?” Ai u përgjigj: **“Rojtar burgu”** Ata thanë: “Përse quhesh kështu?” Ai tha: **“Kjo, sepse unë e mbaj të lidhur (e burgosi) gjuhën time, që ajo të mos i dëmtojë njerëzit (me shpifje, përgojime, fyerje, nënçmime, përqeshje, fjalë të këqija etj).”**

Transmetohet se një person, në prezencën e Maruf el-Kerhit e kishte përgojuar një person tjetër (i cili ky i fundit nuk ishte aty prezent)<sup>18</sup>, Maruf el-Kerhi ndërhynte duke i bërtitur këtij përgojuesit, me çrast edhe i thotë: **“Përkujto pambukun, parfumin e qefinit, si dhe vetë qefinin! Kur të gjitha këto do të jenë në dispozicion për ty, me rastin e vdekjes sate.”**

---

<sup>18</sup> Mejmun bin Sijah nuk përgojonte njeri dhe as nuk toleronte që dikush në prezencën e tij të bënte diçka të tillë (të përgojonte). Ai e ndalte përgojuesin nga përgojimi, e nëse përgojuesi ndalej, Mejmuni e vazhdonte ndejën, përndryshe ngrihej nga ndeja. Shiko, Tehdhib Hiljeh el-Evlja', (1/468).

• Seid bin Xhubejr nuk toleronte që dikush në prezencën e tij të përgojonte njeri. Shiko, Sijer 'Alam en-Nubela', (4/336), Imam Dhehebi.

• Ibn 'Avn, ka thënë: **“Njëherë, në praninë e Muhamed bin Sirinit, disa njerëz e përmendën për të keq një person (i cili nuk ishte aty prezent), ndërsa Muhamedi filloi ta përmend po të njëjtin person për cilësitë më të mira të cilat ia dinte.”** Shiko, Sifeh es-Safveh, (3/242), Ibn Xhevzi.

Vëllai im, ja shiko, ky njeri i zgjuar u frikësua për gradën e besimit (imanit) të këtij përgojuesit, u frikësua edhe për veprat e tij të mira se do të barten mu tek ai personi, të cilin ky përgojuesi e kishte përgojuar!

Hasan el-Basriu, ka thënë: **“Nëse e sheh një person duke i shikuar mangësitë e të tjerëve, ndërsa nuk i shikon mangësitë e veta, dije se ky veçse ka rënë në mashtrim!”**

Gjithashtu, ka thënë: **“Betohem në Allahun, vërtetë përgojimi e prish fenë e besimtarit më shpejtë sesa sëmundja e tij e trupit, e cila ia shqyen trupin.”<sup>19</sup>**

---

• Ahnef bin Kajs, ka thënë: **“Nuk e kam përmendur ndonjë person për të keq, pasi është ngritur nga ndeja dhe ka shkuar.”** Shiko, Sifeh es-Safveh, (3/199), Ibn Xhevzi; Kitab el-Gibeh ve en- Nemimeh,(nr. 61), Ibn Ebi Dunja.

<sup>19</sup> Shiko, Kitab el-Gibeh ve en-Nemimeh,(nr. 52), Ibn Ebi Dunja.

O rob i Allahut, frikësohu prej Tij! Shmangu nga kjo cilësi e ulët, ki kujdes të mos i përgojosh njerëzit, mos e lakmo atë person i cili ka rënë në mashtrim (duke i shikuar mangësitë e të tjerëve, ndërsa nuk i shikon mangësitë e veta) dhe fare nuk e vëren se ka rënë në këtë lloj mashtrimi. Mos ia dhuro veprat e tua të mira filanit e filanes (si pasojë e përgojimit tënd ndaj tyre)<sup>20</sup>, e pastaj në Ditën e Gjykimit të mbetesh i varfër (me shumë pak vepra të mira, apo pa asnjë fare). Kërkojmë nga Allahu të na ruajë nga përfundimi i zhgënjyer dhe largpamësia e paktë!

Përgojimi më i rrezikshëm është ai ndaj dijetarëve, njerëzve të dijes, si dhe studentëve të dijes, edhe nëse dikush prej tyre bie në ndonjë gabim. Vërtetë përsosmëria i takon vetëm Allahut, si dhe të mbrojturit nga gabimet u ka takuar vetëm Profetëve.

Ibn 'Asakiri, ka thënë: **“Atë të cilin Allahu e sprovon me përgojimin e dijetarëve, do e sprovojë edhe me vdekje të zemrës (ngurtësim të saj).”**

Kërkojmë nga Allahu të na ruajë nga vdekja e zemrave!

---

<sup>20</sup> Hasan el-Basriut i është thënë: “Filani të përgojon (flet keq për ty)” Ai u përgjig duke thënë: **“Mirëseardhshin veprat e mira! Për të cilat nuk kam bërë punë e as përpjekje, si dhe të cilat nuk përbëjnë vetëpëlqim e as dyfaqësi.”**  
Shiko, El-Mexhmu' el-Lefif, (fq. 196).

---

• Fudejl bin 'Ijad, ka thënë: **"Dashakeqi yttë dhuron ty vepra të mira më shumë sesa dashamiri yt, kjo sepse kur ti përmendesh në prani të dashakeqit tënd, ai të përgojon ty. Vërtetë vetëm një i ngratë t'i dhuron veprat e tij të mira."**

Shiko, El-Muxhaleseh ve Xhevahir el-'Ilm, (nr. 1346).

• 'Abdullah bin el-Mubarek, ka thënë: **"Nëse do e përgojoja dikë, do t'i përgojoja të dy prindërit e mi, sepse ata të dy më së shumti e meritojnë që të marrin hise nga veprat e mia të mira."**

Shiko, Er-Risaleh el-Kushejrijeh, "Kapitulli i përgojimit", (fq. 285); Sherh Sahih el-Buhari, (9/245), Ibn Battal.

• Transmetohet se njeriut në Ditën e Gjykimit do t'i jepet libri (në të cilin janë të regjistruara veprat e tij), ai do të shohë aty të regjistruara vepra të mira për të cilat nuk ka punuar asnjëherë më parë, me çrast do t'i thuhet: **"Kjo, sepse njerëzit të kanë përgojuar, ndërsa ti nuk ke qenë në dijeni për këtë."**

Shiko, Er-Risaleh el-Kushejrijeh, "Kapitulli i përgojimit", (fq. 285).

• Hasan el-Basriu, thoshte: **"Kini kujdes nga përgojimi! Beto hem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, vërtetë përgojimi i djeg punët e mira më shpejtë sesa zjarri që i djeg drunjtë."**

Shiko, Kitab el-Gibeh ve en-Nemimeh, (nr. 161), Ibn Ebi Dunja.

• Evzaiu, ka thënë: "E kam dëgjuar Jahja bin Ebi Kethir, duke thënë: "Në Ditën e Gjykimit do t'i thuhet robit: **"Shko te filani dhe merr të drejtën tënde që të përket"** Robi do të thotë: "O Zot! Unë nuk e ditkam se tek ai paskam diçka që më përket mua ta marr?" Pastaj do t'i thuhet: **"Si jo, sepse ai të ka përmendur ty për të keq, po në këtë ditë kështu e kështu, po në këtë ditë kështu e kështu."**

Shiko, Kitab el-Hulum, (nr. 121), Ibn Ebi Dunja.

• Ibn Xhevzi, ka thënë:

**"Sa e sa punë të mira të cilat janë bërë nga të devotshmit, përgojimi i ka asgjësuar; sa e sa shpërblime të cilat janë fituar nga punëmirët, përgojimi i ka zhvlerësuar; sa e sa hidhërime ndaj Zotit të gjithësisë, përgojimi i ka shkaktuar!"**

Shiko, Et-Tedhkirah fi el-Va'dh, (fq. 124), Ibn Xhevzi.

• Ka'bi, ka thënë: **"Përgojimi i asgjëson veprat e mira."**

Shiko, Kitab el-Gibeh ve en-Nemimeh, (nr. 49), Ibn Ebi Dunja.

---

• ‘Ubejdeh es-Selmani, ka thënë: **“Kini kujdes nga dy gjëra të cilat e prishin agjërimin, ato janë: përgojimi dhe gënjeshtria.”**

Shiko, Kitab el-Gibeh ve en-Nemimeh, (nr. 40), Ibn Ebi Dunja.

• Enesi, (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: **“Nëse agjëruesi përgojon (gjatë agjërimit të tij), e prish agjërimin.”**

Shiko, Kitab ez-Zuhd, “Kapitulli rreth atij i cili përgojon duke qenë agjërues”, (nr. 1204), Imam Hanad.

Ibn Haxher el-Hejtemi, ka thënë: “Për përgojimin është bërë e qartë se është sëmundje e keqe dhe helm i cili për gojët e përgojuesve është më i këndshëm sesa uji i freskët. Profeti, (ﷺ), njeriu i cili edhe pse ka thënë shprehje të shkurta, porse me kuptime të mëdha, e ka llogaritur të ndaluar përgojimin ashtu siç e ka llogaritur të ndaluar vjedhjen e pasurisë dhe vrasjen me pa të drejtë, dhe kjo bazohet në hadithin e transmetuar: **“Muslimani në tërësi është i paprekshëm nga muslimani tjetër: qoftë gjaku, pasuria dhe nderi i tij.”**<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> Shiko, Ez-Zevaxhir an Iktiraf el-Keba'ir, (2/25), Ibn Haxher el-Hejtemi.

## PËRGJIGJE NGA IBN TEJMIJE

Pyetja: A lejohet përgojimi ndaj personave konkretë, çfarë dispozite ka një gjë e tillë? Na jep një përgjigje detajisht për këtë çështje, në mënyrë që të përfitojnë nga kjo edhe ata të cilët urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja?

Përgjigja: Falënderimi i takon Allahut, Zotit të gjithësisë! Në lidhje me këtë temë, fillimisht duhet kuptuar se përgojimi është pikërisht ashtu siç e ka sqaruar Profeti, (ﷺ), në një hadith autentik kur është pyetur në lidhje me këtë, e ai u përgjigj duke thënë: **“Përgojimi është ta përmendësh vëllain tënd (para njerëzve) për diçka që ai nuk ka fare dëshirë.”** Pastaj përsëri u pyet: “Çfarë mendon nëse ajo për të cilën unë e përmend vëllain tim (para njerëzve) është e vërtetë?” Ai, (ﷺ), u përgjigj duke thënë: **“Nëse është e vërtetë ajo për të cilën ti e përmend atë, megjithatë ky është përgojim ndaj tij, ndërsa nëse nuk është e vërtetë ajo për të cilën ti e përmend atë, në këtë rast kjo është shpifje ndaj tij.”**

Profeti, (ﷺ), e ka bërë të qartë dallimin ndërmjet përgojimit dhe shpifjes. Gënjeshtria ndaj muslimanit konsiderohet shpifje ndaj tij. Në fakt është e ndaluar gënjeshtria ndaj cilido person në përgjithësi, pavarësisht ky person është musliman apo



jomusliman, ndërsa gënjeshtër (shpifja) ndaj muslimanit është edhe më e keqe. Ai, (ﷺ), e ka bërë të ndaluar përgojimin ndaj muslimanit për shkak të vëllazërisë fetare me të, dhe se shëmtira e përgojimit është varësisht se çfarë grade të përkushtimit fetar ka muslimani i përgojuar. Sa më e lartë që është grada e tij e përkushtimit fetar, aq më i shëmtuar është edhe të përgojuarit ndaj tij.

## CITATI I IBN KAJIMIT:

**“Çdo pjesë e trupit do ta shijojë dënimin që meriton, ku secila do të dënohet varësisht se çfarë mëkati ka bërë. Gojët e përgojuesve të cilat e hanë mishin e njerëzve (i përgojojnë ata), si dhe e cenojnë nderin e tyre, do të priten me gërshërë prej zjarri.”<sup>22</sup>**

Ai i cili dëshiron shpëtim për vetën e tij, le ta lexojë këtë citat të këtij Imami, ku tregoi se ai person i cili fliste keq për njerëzit, me fjalë përgojuese, të cilat buronin nga goja e tij, pastaj në berzah (jetën e varrit) dënimi të cilin do ta shijojë është të pritet goja e tij me gërshërë prej zjarri. Kërkojmë prej Allahut mbrojtje të na ruajë nga zjarri!

O vëllai im, Allahu na ruajtë neve dhe ty! Dije se shembulli më i mirë është Profeti Muhamed, (ﷺ), pastaj prijësit e drejtë, pastaj të gjithë Sahabët (shokët) tjerë të tij, pastaj pasuesit e tyre në rrugën e drejtë, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!

---

<sup>22</sup> Shiko, Tuhfetul-Mevdud bi Ahkam el-Mevlud, (fq. 430), Ibn Kajjim el-Xhevzijeh.

Ai i cili nuk e njeh rrugën profetike (sunetin), por edhe në qoftë se e njeh, nuk e pason përveç në ato raste kur egoja e tij përshtatet me të, një i mençur duhet të largohet me të gjitha mënyrat nga ky person dhe të mos shoqërohet me të. Rrugën profetike (sunetin) dijetarët e kanë marrë shembull sikurse shembulli i anijes së Nuhut, ai i cili ka hipur në anije, ka shpëtuar, ndërsa ai i cili ka refuzuar të hipë, është përmbysur në ujë.

Thashethemet, (nga Allahu kërkojmë mbrojtje!), janë shtiza vdekjeprurëse dhe sëmundje të këqija, gjithashtu për gojët e injorantëve ato janë më të këndshme sesa uji i freskët.

Thashetheme do të thotë: Bartja e fjalëve prej disa personave e deri te disa persona të tjerë, në mënyrë që të prishet uniteti i tyre ndërmjet vete. Thashethemexhiu bie në kundërshtim me porosinë e Allahut, e kjo porosi është të përmirësohet uniteti ndërmjet besimtarëve, siç thotë i Lartësuari: **“S’ka dyshim, se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj...”**

**(El-Huxhurat: 10)**

Pra, thashethemexhiu bie në kundërshtim me këtë porosi, sepse ai bart fjalë ndërmjet muslimanëve, në mënyrë që të prishet uniteti i tyre ndërmjet vete. Allahu thotë: **“...përmirësoni gjendjen e unitetit tuaj...”**

**(El-Enfal: 1)**

Thashethemexhiu e prish unitetin e muslimanëve (duke bartur fjalë ndërmjet tyre), dhe në fund arrihet shkëputja e këtij uniteti (të cilin më parë e patën në

rregull), ashtu siç është transmetuar në hadith profetik.

Në Kuranin e Madhërishëm ka ardhur ndalesa që të bëhet bartje fjalësh. Allahu i Lartësuar thotë: **“Që është përgojues e bart fjalë ndër njerëz.”**

**(El-Kalem: 11)**

Ibn Kethiri, duke komentuar rreth këtij ajeti kuranor, thotë: **“Këtu është për qëllim për atë i cili shkakton probleme ndërmjet njerëzve, fut mosmarrëveshje dhe bart fjalë ndërmjet tyre, në mënyrë që të prishet uniteti i tyre ndërmjet vete, dhe në fund arrihet shkëputja e këtij uniteti (të cilin më parë e patën në rregull).”<sup>23</sup>**

---

<sup>23</sup> Shiko, Tefsir el-Kuran el-'Adhim, (7/344), Imam Ibn Kethir.

Fjala e Allahut në lidhje me bashkëshorten e Ebu Lehebit: “...ajo që barti dru (ferra).”

**(El-Mesed: 4)**

Një komentim rreth këtij ajeti kuranor, thotë se ajo ishte grua e cila bartte fjalë ndërmjet njerëzve<sup>24</sup>, pra, ajo ka qenë thashethemexhie. Gjithashtu në këtë kontekst, thashethemet emërtohen si drunj, për shkak se e ndezin zjarrin e armiqësisë ndërmjet njerëzve (sikurse drunjtë që e ndezin zjarrin).

Profeti, (ﷺ), ka thënë (duke treguar shkakun e dënimit të njërit nga ata dy persona të cilët dënoheshin në varr): “...ndërsa tjetri bartte fjalë ndërmjet njerëzve.”

Ibn ‘Abbasi, (Allahu qoftë i kënaqur me këta të dy!), ka thënë: “**Kush vjen tek ti duke bartur fjalë për të tjerët, po i njëjti është ai i cili shkon edhe te të tjerët, duke bartur fjalë për ty. Prandaj ki kujdes nga ky person!**”

---

<sup>24</sup> Muxhahidi, duke komentuar rreth ajetit kuranor: “...ajo që barti dru (ferra).” (El-Mesed: 4), ka thënë: “Ajo (bashkëshortja e Ebu Lehebit) bartte fjalë ndërmjet njerëzve.”

Shiko, Kitab es-Samt ve Adab el-Lisan, (nr. 263), Ibn Ebi Dunja.

Në dashtë Allahu, këtë fragment tani do ta përmbyllim duke treguar në fund se çfarë pasojash rezultojnë mëkatet.

Disa prej këtyre pasojave janë:

1. Mëkatet me doemos shkaktojnë poshtërim (në pozitën e mëkatarit) dhe vërtetë e gjithë krenaria është në bindje ndaj Allahut të Lartësuar, siç ka thënë 'Abdullah bin el-Mubarek në formë të poezisë:

**“E kam vërejtur se mëkatet e ngurtësojnë zemrën,  
Dhe se varësia pas tyre mund të shkaktojë poshtërim,  
Braktisja e tyre është gjallëri për zemrën,  
Prandaj për ty është më mirë që egos satet'i drejtohesh  
me kundërshtim.”**

2. Mëkatet e dëmtojnë mendjen, dhe se mendja është dritë.

3. Nëse mëkatar kryen mëkate të shumëta, zemra e tij do të vulozet pastaj.

4. Mëkatet në zemër e shuajnë zjarrin e xhelozisë.

5. Mëkatet e zhdukin turpin.

6. Për shkak të mëkateve, zemra e mëkatarit e pakëson madhërimin ndaj Zotit.

7. Mëkatet në zemrën e mëkatarit mbjellin vetmi të madhe, dhe ai do të ndihet i vetmuar.

8. Mëkatet e nënçmojnë mëkatarin dhe e poshtërojnë atë.

9. Mëkatarit i ulet pozita, autoriteti dhe vlera para Allahut dhe krijesave të Tij.

10. Mëkatet e hedhin mëkatarin në gradën më të ulët, pasi ai më parë ka qenë në gradë të lavdëruar.

11. Ndryshimi i zemrës: SubhanAllah, sa e sa zemra janë ndryshuar dhe rrotulluar (për të keq), ndërsa pronari i asaj zemre nuk është në dijeni për këtë. Sa e sa persona janë sprovuar me lëvdatat e njerëzve, janë mashtruar me perden me të cilën Allahu ua mbulon të metat e tyre, si dhe janë joshur me begatitë e Allahut të cilat Ai ua dhuron!

Pra, e gjithë kjo ishte një përmbledhje e thjeshtëzuar brenda këtij fragmenti të shkurtër. Shpresojmë nga Allahu i Cili është Bujar dhe Madhështor, që këtë punim ta llogaritë vepër të sinqertë dhe të kryer vetëm për



Fytyrën e Tij Fisnike, t'ia mundësojë të përfitojë prej këtij punimi atij që e lexon dhe atij pranë të cilit lexohet, ta ndihmojë atë i cili jep kontribut për t'u përhapur në mesin e vëllezërve muslimanë, gjithashtu t'ia fal mëkatet dhe ta shpërblejë me të mira. Mëshira dhe paqja e Allahut qofshin për Muhamedin, për familjen dhe të gjithë shokët e tij!

**Muhamed bin Sulejman el-'Ulejti**

**“ Sa e sa punë të mira të cilat janë bërë nga të devotsbmit,  
përgojimi i ka asgjësuar;  
sa e sa shpërblime të cilat janë fituar nga punëmirët,  
përgojimi i ka zhvlerësuar;  
sa e sa hidbërime ndaj Zotit të gjithësisë  
përgojimi i ka shkaktuar! ”**

**Ibn Xhevzi**